

Prishtinë: 24.05.2005

Kodi i ZRrE-së: D_ 48_2007

Nr. i Referencës: ERO/CPD_R_15_05_07

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Rregulloren Nr. 2001/17 Ndryshimi i rregullorës Nr. 2001/11 për Tatimin mbi vlerën e shtuar, neni 11;
4. Ankesën e bërë nga konsumatori në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 09.11.2006 me numër regjistrimi 23/11 2007;
5. Marrëveshjen (Kontrata nr. MIK/CO 002/04) mes UNMIK dhe znj. Vitosevic (në emër të znj. Jovica Nedelkovic) të nënshkruar më 01 Korrik 2003;
6. Marrëveshjen për shfrytëzim të energjisë elektrike të datës 29.06.2004 respektivisht 21.06.2004 mes UNMIK dhe KEK;
7. Shtesën (addendum one) e marrëveshjes për shfrytëzim të energjisë elektrike të nënshkruar më datë 15 Korrik 2005 mes UNMIK dhe KEK;
8. Përmirësimet (amendamentet) nr. 3 të bëra në kontratën nr. MIK/ CO 002/04 mes UNMIK dhe znj. Slavica Vitosevic (në emër të znj. Jovica Nedelkovic) me datë 13.06.2006;
9. Përgjigjen e KEK-ut të datës 28.10.2006 në ankesën e konsumatorit për lirim nga pagesa për TVSH;
10. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRrE-së, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të datës 23.05.2006 Nr. ZRrE/DMK_R_15_05_07; dhe
11. Nenin 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 23.05.2005 morri këtë:

VENDIM

Ankesa e Konsumatorit UNMIK ADMIN. H.Q nga RAHOVECI të **PRANOHET** për arsye të paraqitura në arsyetim të këtij Vendimi.

Arsyetimet

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar KEK-ut Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë – Distriktit në Prizren me datë 04.10.2006 ka kërkuar që të lirohet nga pagesa e ngarkuar nga KEK-u për TVSH (Tatimin mbi Vlerën e Shtuar).
2. Me 28.10.2006 Divizioni i Furnizimit në Distriktin e Prizrenit (KEK) ka dhënë përgjigje konsumatorit në ankesën me datë 04.10.2006, duke e refuzuar konsumatorin dhe duke e informuar për të drejtat e tij në apelimin e vendimit të KEK-ut në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
3. Konsumatori ka bërë apelimin në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRrE-së në faturimin e KEK-ut ngarkuar konsumatorit për pagesën për TVSH.
4. Konsumatori në kërkesën e tij ka shpjeguar se UNMIK-u nuk duhet të paguaj pagesën për TVSH.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga konsumatori dhe KEK-u si dhe bisedës me përfaqësuesit e konsumatorit dhe KEK-ut, ka propozuar Bordit të ZRrE-së që të pranoj ankesën e konsumatorit me numër 23/11 2006 për arsye si në vazhdim:
 - 5.1 Konsumatori ka paraqitur në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRrE-së kontratën mes UNMIK-ut dhe zt. Nedelkovic (në vend të zt. Nedelkovic është autorizuar të nënshkruaj marrëveshjen zt. Slavica Vitosevic) për qiradhëdhënie, ku fillimi kontratës është me datë 1 Korrik 2003 dhe skadimit me datë 30 Qershor 2004 (kontrata nr. MIK/CO 002/04).
 - 5.2 Poashtu konsumatori ka paraqitur në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRrE-së kontratën e furnizimit mes KEK-ut dhe UNMIK-ut të nënshkruar nga të dy palët me datë 29.06.2004 respektivisht 21.06.2004.
 - 5.3 Konsumatori ka paraqitur në DMK edhe marrëveshjen mes UNMIK dhe KEK të datës 15 Korrik 2005 për shfrytëzim të energjisë elektrike (“addendum one (1)”).
 - 5.4 Konsumatori ka paraqitur në DMK edhe dokumentin të nënshkruar (Amandamentin nr. 3, kontrata nr. MIK/CO 002/04) me datë 13.06.2006 ku ka bërë zgjatjen e kontratës deri më 30 Qershor 2006, mirëpo në kontratë ceket që të ndryshohet data nga 30 Qershor 2006 deri më 30 Qershor 2007.
6. Më 23.05.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta pranoj** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 5 të këtij Vendimi.
7. Në bazë të dëshmimeve të lartpërmendura obligohet KEK-u që konsumatorin UNMIK ADMIN. H.Q mos ta faturoj me TVSH nëpër faturat e energjisë elektrike. Poashtu KEK-u obligohet që t’ia heq konsumatorit UNMIK ADMIN. H.Q shumën e ngarkuar për TVSH që nga data 1 Janar 2005 e tutje.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Kompetent të Prishtinës, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së

Antarët e Bordit:
